

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Moderniteti - Inovacioni është seks
ADRESA	https://www.syri.net/sociale/917830/inovacioni-eshte-seks/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 13:05:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 11:49:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	222647b14f4287e0891d6419a45a8bd1fe6bf28f035d90a1092dcc865ee05cc2
TEKSTI	40c6164051ad4d907d6b81f4377f130a433c9efb8a9351c64f1204d70144c4c1
PAMJA	d11d880740601eeb5dbc4d128f959b6d9ef0ede32f95a082303488a07f0fa200

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8c491081561a74ae432001cdd976e460417feb2dfeac682d9a8d81c8d56eaada
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aea7d85c4e1ffedb330a4f0c595bceb62319ead8019dd1bf570799cb9f2d4d85
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8c491081561a74ae432001cdd976e460417feb2dfeac682d9a8d81c8d56eaada>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



NDRIÇIM KULLA
Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit
siamezë të dekadencës
demokratike evropiane



PROF. MYQEREM TAFAJ
Shqipëria e harruar fillon aty
ku shkolla mbetet pa nxënës!



më të lexuarat

'Më ka bllokuar rrugën, e kam me dokumente'/ Qytetari nga Korça: Do vritemi, më ka izoluar

Kufizohet lëvizja në Urën e Matit, ndalohet kalimi i mjeteve mbi 13 ton

Pa treg rrobash/ Tregtarët ambulantë ngrihen në protestë: Bashkia dhe PS e premtuan, tani s'përgjigjen

Pse po përkeqësohen adoleshentët në shkollë

Inovacioni është seks

Kompleksiteti seksual i mashkullit spanjoll

Vodafone sjell për herë të parë në Shqipëri WiFi7. teknologjinë më të



Inovacioni është seks

13:49, 19/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Nga Ross Blankenship – Psychology Today/

Çfarë mund të na mësojë puna e Esther Perel për organizatat tona?

Esther Perel është në qendër të vëmendjes.

Ajo ka qenë konsulente për filmin e Olivia Wilde dhe Seth Rogen, The Invite; Apple TV sapo e ka angazhuar për të drejtuar emisionin e saj të parë të takimeve, The Last Person on Earth; dhe në dhjetor do të nisë një shfaqje të re live, Strangers, Friends, and Lovers: A Night Out With Esther Perel. Ah, dhe meqë ra fjala, këtë vit shënohet 20-vjetori i librit të saj të suksesshëm dhe me ndikim, Mating in Captivity. Mund të themi me siguri se ajo ka zbuluar diçka që na intereson.

Kur doli Mating in Captivity, besimi i përhapur për çiftet ishte se afërsia emocionale çon në një jetë seksuale më të mirë. Por në librin e saj, ajo shpjegon pse kjo nuk është plotësisht e vërtetë. Po, afërsia emocionale është e mirë për marrëdhëniet; ajo krijon stabilitet dhe intimitet (me qëllim fjalën e përdorur), por nuk e ndez domosdoshmërisht dëshirën. Dëshira ushqehet nga risia, ndërsa risia kërkon mister dhe kureshtje, madje edhe pasiguri. Siç shprehet Perel:

"Dashuria kënaqet duke ditur gjithçka për ty; dëshira ka nevojë për mister. Dashuria dëshiron ta zvogëlojë distancën që ekziston mes meje dhe teje, ndërsa dëshira merr energji nikërisht nga kjo distancë. Nëse intimiteti rritet në mes

përsëritjes dhe familjaritetit, erotizmi mpaket nga përsëritja. Ai lulëzon përmes misterit, risisë dhe të papriturës."

Kjo krijon një lloj paradoksi në marrëdhëniet tona. Nëse synimi është të kemi stabilitet dhe lidhje të forta emocionale, por njëkohësisht edhe dëshirë dhe jetë seksuale të fortë, çfarë duhet të bëjmë?

Prit, çfarë lidhjeje ka kjo me punën?

Ajo që është veçanërisht interesante në përhapjen e vazhdueshme të punës së Perel në kulturën e zakonshme është se sa lehtë zbatohen idetë e saj në fusha të tjera. Modelet e marrëdhënieve që ajo përshkruan shfaqen vazhdimisht në jetën tonë të përditshme dhe në vendet tona të punës, ndonëse në forma më pak romantike.

Ne i krijojmë ekipet dhe organizatat në mënyrë që të jenë sa më të qëndrueshme dhe të parashikueshme, dhe më pas habitemi kur ato fillojnë të duken të ngurta dhe të vjetruara. Përpiqemi të krijojmë sisteme pa pengesa që na ndihmojnë të jemi sa më produktivë, por më pas e kemi të vështirë të kuptojmë pse puna jonë duket pa frymëzim. Tensionet që krijohen kur i japim tepër rëndësi stabilitetit dhe parashikueshmërisë janë të ngjashme me ato që mund të përshkruajmë në një marrëdhënie.

Ashtu si marrëdhëniet formohen nga rutinat, modelet e sjelljes mbi të cilat një grup mbështetet kur zgjidh problemet së bashku përcaktojnë kulturën organizative (Schein dhe Schein, 2017). Kompanitë në fazat e para zakonisht përballen me shumë pasiguri, ndërsa përpiqen të përcaktojnë produktin ose shërbimin e tyre dhe mënyrën se si do ta ofrojnë atë në treg. Për këtë arsye, ato priren të jenë edhe mjedise emocionuese dhe inovative. Suksesi në fazat e para nënkupton të mësosh se si ta ofrosh një produkt ose shërbim në shkallë të gjerë, gjë që kërkon sisteme dhe procese. Me kalimin e kohës, të njëjtat rutina që mundësojnë ofrimin e qëndrueshëm të produktit, dhe që krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme, janë ato që bëjnë që gjërat të ngurtësohen.

Problemi nuk janë vetëm sistemet dhe rutinat

Tensioni mes dëshirës sonë për stabilitet dhe krijimtarisë është i rëndësishëm për mënyrën se si mendojmë për kulturën organizative dhe ndryshimin, por këtu ekziston një dinamikë më e thellë që nuk mund të anashkalohej: besimi. Dhe kur flasim për besimin, flasim për rrezikun dhe pasigurinë. Rachel Botsman e përkufizon besimin si "një marrëdhënie të sigurt me të panjohurën". Besimi që u lejon dy njerëzve të rrezikojnë të jenë të pambrojtur me njëri-tjetrin ka një paralele të drejtpërdrejtë me sigurinë psikologjike, e cila i lejon një anëtar të ekipit të rrezikojë të shprehë me zë një ide të keqe.

E megjithatë, ashtu si një çift mund të ketë shumë besim dhe aspak dëshirë, një organizatë mund të ketë shumë siguri psikologjike dhe aspak inovacion. Besimi është i domosdoshëm, por nuk mjafton, si për marrëdhëniet, ashtu edhe për organizatat.

Në fakt, shikoni çfarë ndodh kur e përkthej thjesht citimin e mësipërm në gjuhën e organizatave:

Organizatave u pëlqen të dinë gjithçka për mënyrën se si funksionojnë; inovacioni ka nevojë për mister. Organizatat duan ta zvogëlojnë distancën mes ideve dhe zbatimit të tyre, ndërsa inovacioni merr energji pikërisht nga kjo distancë. Nëse organizatat përmirësohen përmes përsëritjes dhe familjaritetit, inovacioni mpaket nga përsëritja. Ai lulëzon përmes misterit, risisë dhe të papriturës.

Perel sigurisht që nuk e shkroi Mating in Captivity si një libër për menaxhimin, por 20 vjet më vonë, ai mund të lexohet fare mirë edhe si i tillë. Modelet që ajo vërejt në dhomat e gjumit mund të përshkruajnë po aq mirë edhe sallat e mbledhjeve dhe ekipet e produkteve.

Prandaj, nuk është rastësi që mund të kuptojmë se ku duket se po drejtohet më tej mendimi i Perel. Në TED këtë vit, në një sesion të quajtur Relational Metamorphosis, ajo e ndërtoi fjalimin e saj rreth një ideje që tashmë duhet të na tingëllojë e njohur: fërkimi, gjëja që shpenzojmë pjesën më të madhe të energjisë duke u përpjekur ta shmangim, është në fakt lënda e parë për transformimin, si në nivel personal, ashtu edhe kolektiv. Në shkallë shoqërore, ajo po bën të njëjtin argument që bëri për dëshirën në nivelin e marrëdhënieve 20 vjet më parë. Jemi bërë aq të zotë në eliminimin e fërkimeve nga jeta jonë, saqë kemi eliminuar edhe kushtet që i lejojnë diçkaje të re të ndodhë.

Atëherë, çfarë bëni me një organizatë që është bërë tepër efikase për të bërë risi?

Krijoni pak fërkim të dobishëm (Blankenship dhe Sass, 2026). Mund të rishikoni

avancuar për internetin në shtëpi

Ç'lidhje ka trauma e fëmijërisë me supremacinë e të bardhëve?

Syri Tv/ Ish-luftëtarët e UÇK-së mbërrijnë në Durrës pas Hagës: O Hashim, ti ku je, UÇK-në këtu e ke

një proces që e keni automatizuar së fundmi dhe të përcaktoni pasojat e mundshme negative të automatizimit. Mos supozoni se shtimi i inteligjencës artificiale (IA) në çdo proces do ta përmirësojë domosdoshmërisht atë. Përveç nevojës për të ruajtur një nivel të caktuar gjykimi njerëzor dhe ndjeshmërie në marrëdhëniet brenda organizatave tona, përhapja e IA demotivon punonjësit.

Mund të lini kohë për të menduar pa një kthim të dukshëm të investimit. Planifikoni kohë të pastrukturuara si pjesë të punës suaj. Quajeni "kohë për të shkruar", nëse kjo ju ndihmon, por ndiqni këshillën e Jerry Seinfeld: gjatë asaj kohe nuk jeni të detyruar të shkruani, por nuk mund të bëni asgjë tjetër. Lëroni një ekip të mbledhet vetëm për të komunikuar; lëroni të qëndrojnë me një ide ende të paplotë. Rrisni distancën mes ideve dhe zbatimit të tyre.

Lejoni përplasje të paparashikueshme mes njerëzve, në vend që çdo ndërveprim të kalojë përmes një mbledhjeje ose një procesi. Lëroni njerëzit të luajnë dhe të eksplorojnë ide të reja.

Ja sekreti: Asnjëra nga këto ide nuk do ta zgjidhë problemin. Por ja edhe një sekret tjetër: pikërisht ky është qëllimi. Ky lloj problemi nuk mund të zgjidhet plotësisht; është një dinamikë me të cilën duhet të eksperimentosh dhe të ndërhysh gradualisht. Kërkon të provosh diçka të re, të shohësh se çfarë ndodh, të reflektosh mbi të dhe më pas të provosh diçka tjetër. Kjo mund të jetë mjaft e parehatshme; në fund të fundit, kemi të bëjmë me pasigurinë. Por pikërisht kur e presim më pak, diçka e re përplaslet në jetën tonë. **/Psychology Today – Syri.net**

© SYRI.net

Lexo edhe:



Vodafone sjell për herë të parë në Shqipëri WiFi7, teknologjinë më të avancuar për internetin në shtëpi



Pse po përkeqësohen adoleshentët në shkollë



Kufizohet lëvizja në Urën e Matit, ndalohet kalimi i mjeteve mbi 13 ton

TË NGJASHME



Horoskopi ditor për sot, e Shtunë 19 Shtator 2026



SYRI TV/ Pa dëmshpërblim pasi u shkrumbuan nga zjarri - Banorët e fshatrave në Fier kërkojnë ndihmë



Syri Tv/ Ish-luftëtarët e UÇK-së mbërrijnë në Durrës pas Hagës: O Hashim, ti ku je, UÇK-në këtu e ke



Ç'lidhje ka trauma e fëmijërisë me supremacinë e të bardhëve?



Kompleksiteti seksual i mashkullit spanjoll



Mediat: Kardinal Simoni u dënua pas meshës për Kenedin, tani kremton lirisht në altarin amerikan



Pa treg rrobash/ Tregtarët ambulante ngrihen në protestë: Bashkia dhe PS e premtuan, tani s'përgjigjen

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net